



Datë: 04.02.2025

Numër Protokoli: 615/2026

A.nr.2020/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.2020/2025, të datës 11.12.2025, të parashtruar nga ankuesja R.D, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të datës 04.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet Procedura Administrative e filluar sipas ankesës A.nr.2020/2025, të datës 11.12.2025, e parashtruar nga ankuesja R.D.

A r s y e t i m

Ankuesja R.D (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 11.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të funksionit shtesë, për angazhim si anëtare e Bordit për Shkollim Specialistik në Ministrinë e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 18.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit më datë 19.12.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 21.01.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokoli: 323/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjen A.nr.2020/2025 të datës 11.12.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7838/2025 të datës 11.12.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja e datës 19.12.2025; Kërkesë e ankueses e datës 26.09.2025; Kopjen e ID-së së ankueses; Vendimin e Këshillit A.nr.1401/2025 të datës 04.09.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 19.12.2025; Akt emërimit e ankueses të datës 23.12.2024; Vendimin e DMZP-së të datës 11.11.2024; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën që mban ankuesja; Vendimin e datës 23.07.2024 të Ministrit të Shëndetësisë; Vendimin e datës 11.09.2024 të Ministrit të Shëndetësisë; Shkresë e datës 09.06.2025; Tabelë e mbajtjes së mbledhjes së Bordit e datës 23.05.2025; Procesverbal i datës 12.05.2025; Tabelë e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 29.04.2025, 28.03.2025, 28.02.2025; Procesverbal i datës 28.02.2025; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 18.09.2024; Procesverbal i datës 18.09.2024; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 25.10.2024; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 18.10.2024; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 15.11.2024; Procesverbal i 15.11.2024; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 13.12.2024; Procesverbal i 13.12.2024; Tabele e mbajtjes së mbledhjeve të Bordit e datës 20.01.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat e lëndës konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative lidhur me ankuesen, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 05-10045 të datës 23.12.2024, është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, në pozitën e punës *“Zyrtar i lartë për Integritet Evropian”* në kuadër të Divizionit për Integritet Evropian /Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Vendimit me Nr.152/VII/2024, të datës 22.07.2024, i plotësuar dhe ndryshuar përmes Vendimit Nr.170/IX/2024 të datës 11.09.2024 të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, është emëruar anëtare e Bordit për Shkollim Specialistik.

Më tej, ankuesja më datë 26.09.2025, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e funksionit shtesë tek u.d. Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa kjo e fundit me datë 01.10.2025, i'u është përgjigjur ankueses se bazuar në nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 10/2023, kompensimi për funksion shtesë lejohet vetëm nëse plotësohen të gjitha kriteret në mënyrë kumulative, përfshirë kriterin në nën-paragrafin 2.6 i cili përcakton se: ... *“Komisioni nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...”*, duke ju referuar edhe Vendimit me numër të protokollit 05-754 i datës 23.11.2022, i cili përcakton se: ...Të gjithë trupat profesionale të cilët emërohen me vendim të ministrit dhe derivojnë nga legjislacioni në fuqi kompensohen duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për kompensimin e funksionit shtesë. ... *“Zyrtaret e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët shërbejnë në borde komisione dhe trupa të tjera profesionale, nuk marrin kompensim për angazhimin e tyre në këto trupa...”*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka të drejtë në kompensimin e shtesës në emër të funksionit shtesë për shkak të angazhimit në Bordin për Shkollim Specialistik duke ju referuar kështu dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë dhe duke ju referuar akteve ligjore kërkon që të aprovohet ankesa dhe të obligohet Ministria e Shëndetësisë, që në cilësinë e anëtares së Bordit për Shkollim Specialistik, ti bëjë kompensimin për funksionin shtesë si anëtare e bordit në mënyrë retroaktive nga data e vendimit të ministrit.

Marrë parasysh se objekti i ankesës së ankueses ka të bëjë me kompensim për funksion shtesë dhe duke qenë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çështja të njëjtë dhe institucion të njëjtë, më Vendimin A.nr. 32/2024 të datës 23.02.2024, kishte refuzuar ankesën e ankuesve R.H, J.G, H.S, T.A. Sh.U.H dhe A.M, vendim ky i anuluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, e më të cilin aktgjykim është detyruar Ministria e Shëndetësisë që ankuesve t'i bëjë kompensimin në emër të angazhimit për punë shtesë si kryesues dhe anëtarë të trupave profesionale. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër aktgjykimit A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, ka parashtruar ankesë më datë 03.11.2025 në Gjykatën e Apelit të Kosovës, më të cilën konteston Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Andaj, mbi këto rrethana, dhe duke qenë se Aktgjykimi A.nr.1411/2024, i datës 27.08.2025, nuk është përfundimtar pasi që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka ushtruar ankesë kundër të njëjtit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*, vendosi për pezullim të procedurës të iniciuar sipas ankesës A.nr.2020/2025, e datës 11.12.2025, e parashtruar nga ankuesja R.D.

Prandaj, Kolegji i Këshillit thekson faktin se procedura administrative e iniciuar sipas ankesës së ankueses të datës 11.12.2025, do të mbetet e pezulluar deri në vendimin përfundimtar lidhur me çështjen administrative/gjyqësore A.nr.1411/2024.

Andaj, u bazuar si me lartë dhe në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në pikën I të dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2020/2025, datë 04/02/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses R.D;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.